

KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 166, FDH-23816; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Dalibor (Stojan) Lazarević

(20.09.1982, serb nga Krusheva e Madhe/Veliko Kruševo, komuna e Klinës/Klina, nxënës)

Dalibori me nënën Dobrilen, vëllezërit dhe motrat jetonin në *Mëhallën Naglavke* në **Krushevë të Madhe/Veliko Kruševo**. Ishte më i madhi prej fëmijëve dhe shkonte në klasën e parë të shkollës së mesme teknike. Në datën **20.05.1998**, forcat e UÇK-së e sulmuan fshatin. Krismat dëgjoheshin tërë natën. Rreth orës 22:00, katër pjesëtarë të maskuar të UÇK-së erdhën te shtëpia e familjes Lazarević. Hyrën brenda dhe i rrahën me shpulla vëllezërit dhe motrat e Daliborit, ndërkaq motrën më të vogël të tij e gjuajtën nga krevati. E ëma e Daliborit tentoi që të kundërvihej, kur ata e morën Daliborin me vete, por ata e goditën me kondak në kokë. Rreth 50 metra larg shtëpisë dhe afër kalimit hekurudhor, ata e rrëzuan Daliborin në tokë dhe nisën ta rrihnin. Keqtrajtimi ka zgjatur për një kohë dhe, në fund, e zbrazën një rafal plumbash në kokën e tij. Komshinjtë e Daliborit shtënën ndaj sulmuesve dhe, më pas, e ftuan policinë. Pas arritjes në vendngjarje, policët e gjetën trupin e pajetë të Daliborit dhe një sulmues të plagosur pranë tij. Familjarët e kanë varrosur Daliborin në varrezat e Krusheves së Madhe/Veliko Kruševo më 21.05.1998.

Burimet: deklarata D.L, FDH-29655; deklarata A.H, FDH-30971; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 173, FDH-23816; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, XVIII, 255; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; Z. Stijović, *Kosmet...*, 117; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), D.298.33.2, FDH-30884; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), D.298.33.3, FDH-30888; SMIP, *Teroristički...*, III, 905; *Teroristi mučili ubili 67 nedužnih civila*, Politika, 14.09.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>; *Dnevnik od 19. do 24. maja*, Ilustrovaná politika, 16.05.1998, FDH-32204.

Arben (Aziz) Halitaj

(2.01.1976, shqiptar nga Jashanica e Epërme/

Gornja Jošanica, komuna e Klinës/Klina, tekník i mekanikës, pjesëtar i UÇK-së)

Në orët e mbrëmjes së datës **20.05.1998**, Arbeni me tre pjesëtarë të UÇK-së u nisën nga Jashanica e Epërme/Gornja Jošanica për në fshatin Budisalc/Budisavci, ku zhvillohej beteja ndërmjet forcave të UÇK-së dhe atyre serbe. Për shkak të rezistencës së fuqishme të serbëve, pjesëtarë të UÇK-së, në mesin e tyre edhe grupi i Arbenit, lëvizën drejt **Krushevës së Madhe/Veliko Kruševo**. Edhe në këtë fshat u dëgjoheshin të shtëna. Rreth orës 23:00, komshinjtë e Dalibor Lazarević dëgjuan të shtënat që vinin nga drejtimi i shtëpisë së tij. Dolën jashtë dhe shtënën drejt pjesëtarëve të UÇK-së [të shikohet regjistrimi më sipër]. Njërin e plagosën, ndërkaq të tjerë u arratisën. E ëma e Daliborit e kishte vërejtur një pjesëtar të plagosur të UÇK-së në hendek. Ishte i shtrirë atje për disa orë, për sa kohë policia nuk erdhi në vendngjarje. Policët e rrahën këtë pjesëtar të UÇK-së, ndërsa më vonë e morën me vete në Klinë/Klina. Policia kishte konstatuar se bëhej fjalë për Arben Halitajn nga Jashanica e Epërme/Gornja Jošanica.

Në mbrëmjen e datës 21.05.1998, te prindërit e Arbenit erdhi një burrë nga fshati dhe u kumtoi se djalin e tyre e kishin vlarë në Krushevë të Madhe/Veliko Kruševo. Familjarët nuk patën guxim të shkonin ta merrnin trupin e Arbenit. Këtë e bëri burri që u kishte kumtuar lajmin për vdekjen e djalit të tyre. Familjarët e Arbenit kanë mësuar se ai kishte rënë në pusi të policisë serbe, se e kishin plagosur gjatë përlëshjes së armatosur dhe ashtu të plagosur policia e kishte çuar në stacionin policor në Klinë/Klina ku, më pas, kishte dhënë shpirt nga torturimet. Familjarët e kanë varrosur Arbenin në varrezat e Jashanicës së Epërme/Gornja Jošanica. Pas përfundimit të luftës, në muajin gusht të vitit 1999, mbetjet mortore të Arbenit u rivarrosen në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Polac/Poljance [Skënderaj/Srbica].

Burimet: deklarata A.H, FDH-30971; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 173, FDH-23816; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević),